



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASH) NR. 104 /2020 PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E THEMELIMIT DHE PUSHIMIT
TË VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MES) NO. 104 /2020 ON THE CRITERIA AND PROCEDURES FOR THE
ESTABLISHMENT AND TERMINATION OF THE ACTIVITY OF PRE-UNIVERSITY EDUCATION INSTITUTIONS

ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MON) BR. 104 /2020 O KRITERIJUMIMA I PROCEDURE OSNIVANJA I PRESTANAK
AKTIVNOSTI INSTITUCIJE PREDUNIVERZITETSKOG OBRAZOVANJA

Ministri i Arsimit dhe Shkencës,
Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 16 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 17, 16 shtator 2011), në mbështetje të nenit 8 nënparagrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASH)
NR. _____/2020 PËR KRITERET DHE
PROCEDURAT E THEMELIT DHE
PUSHIMIT TË VEPRIMTARISË SË
INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë Udhëzim administrativ përcaktohen kriteret dhe procedurat e themelimit dhe pushimit të veprimitarisë së institucioneve publike edukative-arsimore të nivelit parashkollor (ISCED 0), fillor (ISCED 1), të mesëm të ulët (ISCED 2), të mesëm të lartë (ISCED 3), si dhe të paraleleve të ndara fizike të tyre.

Minister of Education and Science,
Pursuant to Article 5, paragraph 16 of the Law no. 04/L-032 on Pre-university education in the Republic of Kosova, (Official gazette of the Republic of Kosova, no. 17, 16 September 2011), pursuant to Article 8, sub-paragraph 1.4 of the Regulation no. 02/2011 for fields of administrative responsibility of the Prime Minister's Office and Ministries, issues:

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MES)
NO. _____/2020 ON THE CRITERIA
AND PROCEDURES FOR THE
ESTABLISHMENT AND TERMINATION
OF THE ACTIVITY OF PRE-
UNIVERSITY EDUCATION
INSTITUTIONS**

**Article 1
The purpose**

With this Administrative instruction are determined criteria and procedures for the establishment and termination of public educational institutions of the preschool level (ISCED 0), primary (ISCED 1), of lower secondary (ISCED 2), higher secondary (ISCED 3), and their physical separated parallels.

Ministar Obrazovanja i Nauke,
Na osnovu član 5 stav 16 Zakona br. 04/L032 o preduniverzitetskom obrazovanju Republike Kosovo, (Službeni glasnik Republike Kosovo, br. 17,16 septembra 2011), na osnovu člana 8 podstav 1.4 Uredbe br. 02/2011 o administrativnim oblastima Kancelarije premijera i ministarstva, izdaje:

**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO
(MON) BR. _____/2020 O
KRITERIJUMIMA I PROCEDURE
OSNIVANJA I PRESTANAK
AKTIVNOSTI INSTITUCIJE
PREDUNIVERZITETSKOG
OBRAZOVANJA**

**Član 1
Cilj**

Ovim Administrativnim uputstvom utvrđuju se kriterijumi i procedure za osnivanje i prestanak aktivnosti javnih edukativno-obrazovnih institucija predškolski nivo (ISCED 0), osnovni (ISCED 3), kao i njihova fizički izdvojena odeljenja.

<p align="center">Neni 2 Përkufizimet</p>	<p align="center">Article 2 Definitions</p>	<p align="center">Član 2 Definicije</p>
<p>1. ISCED - Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit, të miratuara nga UNESCO, në Konferencën e përgjithshme, në seancën e 29-të, të mbajtur në nëntor të vitit 1997 dhe të ndryshuara më vonë.</p> <p>2. Institucion edukativ-arsimor - çdo institucion që ofron shërbime edukative-arsimore dhe aftësuese në nivelet 0, 1, 2 dhe 3 të ISCED-it.</p> <p>3. Institucion parashkollor – institucion që ofron shërbime edukative të nivelit 0, sipas ISCED-it për fëmijë të moshës 1-6 vjeç.</p> <p>4. Klasë parafillore – program përgatitor për fëmijë të moshës 5-6 vjeç (niveli 0 sipas ISCED-it), i cili ofrohet në kuadër të institucioneve parashkollore ose institucioneve edukative-arsimore të nivelit 1 sipas ISCED-it.</p> <p>5. Paralele e ndarë – degë e institucionit edukativ-arsimor që operon ndaras nga institucioni amë.</p> <p>6. Kodi i institucionit edukativ-arsimor – numri unik identifikues i përcaktuar me vendimin e Ministrisë nr. 24/2 i dt. 14.01.2009 ose me vendime të mëvonshme.</p> <p>7. Ministria – ministria përgjegjëse për arsimin</p>	<p>1. ISCED - The International Standard Classification of Education, adopted by UNESCO at the General Conference, the 29th Session, held in November 1997, and changed later.</p> <p>2. Educational Institution - any institution providing educational and training services at ISCED 0, 1, 2 and 3 levels.</p> <p>3. Preschool institution - Institution providing educational services of level 0 according to ISCED for children aged 1-6 years.</p> <p>4. Pre-primary grade – preparatory program for children aged 5-6 years (level 0 according to ISCED), which is offered within preschool institution or educational institutions of level 1 according to ISCED.</p> <p>5. Separate parallels - Branch of educational establishment operating separately from parent institution.</p> <p>6. Code of educational institution - Unique identification number determined by Minister's Decision no. 24/2 dated. 14.01.2009 or by subsequent decisions.</p> <p>7. Ministry - Ministry responsible for pre-</p>	<p>1. ISCEDE - Međunarodni standardi klasifikacije obrazovanja odobrenih od strane UNESCO, Generalne konferencije, na 29-tom zasjedanju održanom u novembru 1997, i kasnije izmenjenom</p> <p>2. Edukativno-obrazovne institucije - svaka institucija koja omogućava edukativno-obrazovno i osposobljavajuće usluge nivo 0, 1,2 i 3 ISCED-a.</p> <p>3. Predškolska institucija - Institucija koje omogućavaju edukativne usluge nivo 0 prema ISCED-a za deca uzrasta 1-6 godine.</p> <p>4. Predškolski razred - Pripremni program za decu uzrasta 5-6 godina (nivo 0 prema ISCED-u) koji se nudi u okviru predškolske institucije ili edukativno-obrazovne nivo 1 prema ISCED-u.</p> <p>5. Izdvojena odeljenja - Grana edukativno-obrazovne institucije koja deluje odvojeno od matične institucije.</p> <p>6. Kod edukativno-obrazovne institucije - Jedinstveni identifikacioni broj određen odlukom ministra br. 24/2 i dat. 14.01.2009 ili naknadnom odlukom.</p> <p>7. Ministarstvo - Ministarstvo nadležno za</p>

<p>parauniversitar, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi- Ministria e Arsimit dhe Shkencës .</p> <p>8. Zonë malore – zona rurale e banimit me lartësi mbidetare mbi 700 m.</p> <p>9. Zonë kufitare – zona e banimit në largësi deri në 5 km nga vija e kufirit shtetëror të Republikës së Kosovës.</p>	<p>university education, at the moment of entry into force of this Instruction - Ministry of Education and Science.</p> <p>8. Mountain area - Rural residential area with altitude above 700 m.</p> <p>9. Border Area - Residential area up to 5 km from the state border line of the Republic of Kosova.</p>	<p>preduniverzitetsko obrazovanje, u trenutku stupanja na snagu ovog Uputstva - Ministarstvo obrazovanja i nauke.</p> <p>8. Planinsko područje - Ruralna zona za život sa nadmorskom visinom preko 700 m.</p> <p>9. Pogranična zona - Zona naseljenog područja udaljena do 5 km od linije državne granice Republike Kosovo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Themeluesi</p> <p>1. Ministria, me kërkesën e komunës, themelon të gjitha tipet e institucioneve edukative-arsimore të nivelit 1-3 sipas ISCED-it, si dhe paralelet e tyre të ndara jashtë territorit të komunës ku ndodhet institucioni amë.</p> <p>2. Në përbërje të institucioneve edukative-arsimore të nivelit 1 sipas ISCED-it, nga paragrafi 1 i këtij neni mund të jenë edhe klasat parafillore të nivelit 0 sipas ISCED-it.</p> <p>3. Komuna, me pëlqimin e Ministrisë, themelon institucione parashkollore dhe paralele të ndara të institucioneve edukative-arsimore të nivelit 1-3, sipas ISCED-it brenda territorit të saj.</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Founder</p> <p>1. The Ministry, at the request of the municipality, establishes all types of ISCED level 1-3 educational institutions, as well as their separate classes outside the territory of the municipality where the parent institution is located.</p> <p>2. Part of educational institutions by level 1 ISCED paragraph 1 of this Article may be even pre-school classes of level 0 according to ISCED.</p> <p>3. The municipality, with the consent of the Ministry, establishes pre-school institutions and separate parallels of educational institutions of level 1-3 according to ISCED within its territory.</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Osnivač</p> <p>1. Ministarstvo, na zahtev opštine, osniva sve vrste edukativno-obrazovne institucije prema OSCED nivoa 1-3, kao i njihove odvojena odeljenja van teritorije opštine u kojoj se nalazi matična ustanova.</p> <p>2. U sastavu edukativno-obrazovne institucije nivo 1 prema OSCED prema stav 1 ovog člana mogu biti i predškolski razredi nivo 0 prema ISCED.</p> <p>3. Opština, uz saglasnost Ministarstva, osniva predškolske institucije i izdvojena odeljenja edukativno-obrazovnih institucija nivo 1-3 prema ISCED u okviru svoje teritorije.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 4</p> <p style="text-align: center;">Kushtet për themelimin e institucionit edukativ-arsimor dhe paraleles së ndarë</p>	<p style="text-align: center;">Article 4</p> <p style="text-align: center;">Conditions for establishing an educational institution and a separate parallel</p>	<p style="text-align: center;">Član 4</p> <p style="text-align: center;">Uslovi za osnivanje edukativno-obrazovne institucije i izdvojena odeljenja</p>
<p>1. Institucioni edukativ-arsimor ose paralelja e ndarë, mund të themelohet nëse plotësohen këto kushte të përgjithshme:</p> <p>1.1. Raporti mësimdhënës-nxënës është në përputhje me standardet e përcaktuara nga Ministria me aktin nënligjor përkatës;</p> <p>1.2. Mund të sigurohet kuadri mësimor i kualifikuar sipas normativit përkatës të Ministrisë;</p> <p>1.3. Infrastruktura plotëson standardet e përcaktuara nga Ministria me aktin nënligjor përkatës;</p> <p>1.4. Planprogramet mësimore me të cilat punon janë në harmoni me kurrikulat bërthamë për nivelet përkatëse;</p> <p>1.5. Janë siguruar mjetet për financimin e veprimtarisë deri në krijimin e mundësisë për financim nga granti specifik i arsimit;</p> <p>1.6. Ekziston arsyeshmëria ekonomike për themelimin e institucionit ose paraleles së ndarë, me një perspektivë të paktën 5-vjeçare të mundësisë për funksionimin normal të saj.</p>	<p>1. The educational institution or the separate parallel may be established if these general conditions are met:</p> <p>1.1. The teacher-student ratio is in accordance with the standards set by the Ministry with the relevant sub-legal act;</p> <p>1.2. A qualified teaching staff can be provided according to the relevant normative of the Ministry;</p> <p>1.3. The infrastructure meets the standards set by the Ministry with the relevant sub-legal act;</p> <p>1.4. The curriculum with which it work are in line with the core curricula for the respective levels;</p> <p>1.5. Means for financing the activity have been provided until the opportunity for funding from the specific education grant has been created;</p> <p>1.6. There is economic justification for establishing an institution or a separate parallel, with at least 5-year perspective of possibility of its normal functioning.</p>	<p>1. Edukativno-obrazovna institucija ili izdvojeno odeljenje mogu biti osnovane ako su ispunjeni sledeći opšti uslovi:</p> <p>1.1. Odnos nastavnik-učenik je u skladu sa standardima utvrđenih od strane Ministarstvo odgovarajućim podzakonskim aktom;</p> <p>1.2. Može se obezbediti kvalifikovano nastavno osoblje u skladu sa relevantnim normativima Ministarstva;</p> <p>1.3. Infrastruktura ispunjava standarde utvrđenim od strane Ministarstva odgovarajućim podzakonskim aktom;</p> <p>1.4. Nastavni planovi i programi sa kojima rade usklađeni su sa osnovnim nastavnim programima za odgovarajuće nivoe;</p> <p>1.5. Obezbeđena su sredstva za finansiranje aktivnosti do stvaranje mogućnost za finansiranje iz specifično grante za obrazovanje;</p> <p>1.6. Postoji ekonomska opravdanost za osnivanje institucije ili izdvojenog odeljenja, sa najmanje perspektivom od 5 godine mogućnosti njenog normalnog</p>

<p>2. Institucioni edukativ-arsimor mund të themelohet nëse, përveç kushteve të përgjithshme nga paragrafi 1 i këtij neni, plotësohen edhe këto kushte të veçanta:</p> <p>2.1. Institucioni edukativ-arsimor i specializuar i nivelit 0 sipas ISCED-it i ka:</p> <p>2.1.1. Të paktën dy grupe edukative;</p> <p>2.1.2. Të paktën 40 fëmijë, respektivisht 20 fëmijë në institucionin ku shërbimi ofrohet për komunitetet pakicë dhe në zona malore e kufitare.</p> <p>2.2. Institucioni edukativ-arsimor i nivelit 1 sipas ISCED-it i ka:</p> <p>2.2.1. Të paktën nga një paralele për klasat 1-5 dhe të paktën një paralele për klasën parafilllore;</p> <p>2.2.2. Minimum 60 nxënës, respektivisht 30 nxënës në institucionin me mësim në gjuhët e komuniteteve pakicë dhe në zona malore e kufitare.</p> <p>2.3. Institucioni edukativ-arsimor i nivelit 2 sipas ISCED-it i ka:</p> <p>2.3.1. Të paktën nga dy paralele për</p>	<p>2. The educational institution can be established if these special conditions are fulfilled besides the general conditions referred to in paragraph 1 of this Article:</p> <p>2.1. Specialized educational institution of level 0 according to ISCED has:</p> <p>2.1.1. At least two educational groups;</p> <p>2.1.2. At least 40 children, respectively 20 children in the institution where service is offered for minority communities and in mountain and border areas;</p> <p>2.2. Educational institution of level 1 according to ISCED has:</p> <p>2.2.1. At least one parallel per grades 1-5 and at least one parallel for pre-primary grade;</p> <p>2.2.2. Minimum 60 students, respectively 30 students in the institution learning in minority community languages and in mountain and border areas.</p> <p>2.3. Educational institution of level 2 according to ISCED has:</p> <p>2.3.1. At least two parallels per grades</p>	<p>funkeionisanja.</p> <p>2. Edukativno-obrazovna institucija može se osnovati ako su, pored opštih uslova iz stava 1. ovog člana, ispunjeni i sledeći posebni uslovi:</p> <p>2.1. Specijalizovana edukativno-obrazovna institucija nivo 0 prema ISCED-u ima:</p> <p>2.1.1. Najmanje dve edukativne grupe;</p> <p>2.1.2. Najmanje 40 dece, odnosno 20 dece u institucijama u kojoj se pruža usluga za manjinske zajednice i u planinskim i pograničnim oblastima;</p> <p>2.2. Edukativno-obrazovna institucija nivoa 1 prema ISCED ima:</p> <p>2.2.1. Najmanje po jedno odeljenje za 1-5 razred i najmanje jedno odeljenje za predškolski razred;</p> <p>2.2.2. Minimum 60 učenika, odnosno 30 učenika u institucijama u nastavi na jezik manjinskih zajednica i u planinskim i pograničnim oblastima;</p> <p>2.3. Edukativno-obrazovna institucija nivoa 2 prema ISCED ima:</p> <p>2.3.1. Najmanje po dva odeljenja za 6-</p>
--	---	--

<p>klasat 6-9;</p> <p>2.3.2. Minimum 160 nxënës.</p> <p>2.4. Institucioni edukativ-arsimor i nivelit 1 dhe 2 sipas ISCED-it i ka:</p> <p>2.4.1. Të paktën nga një paralele për klasat 1-9 dhe të paktën një paralele për klasën parafilllore;</p> <p>2.4.2. Minimum 100 nxënës, respektivisht 50 nxënës në institucionin me mësim në gjuhët e komuniteteve pakicë dhe në zona malore e kufitare.</p> <p>2.5. Institucioni edukativ-arsimor i nivelit 3 sipas ISCED-it i ka:</p> <p>2.5.1. Të paktën nga tri paralele për klasat 10-12;</p> <p>2.5.2. Minimum 180 nxënës, respektivisht 90 nxënës në institucionin me mësim në gjuhët e komuniteteve pakicë.</p> <p>3. Paralelja e ndarë mund të themelohet nëse, përveç kushteve të përgjithshme nga paragrafi 1 i këtij neni, plotësohen edhe këto kushte të veçanta:</p>	<p>6-9;</p> <p>2.3.2. Minimum 160 students.</p> <p>2.4. Educational institution of level 1 and 2 according to ISCED has:</p> <p>2.4.1. At least one parallel per grades 1-9 and at least one parallel for pre-primary grade;</p> <p>2.4.2. Minimum 100 students, respectively 50 students in the institution learning in minority community languages and in mountain and border areas.</p> <p>2.5. Educational institution of level 3 according to ISCED has:</p> <p>2.5.1. At least three parallels per grades 10-12;</p> <p>2.5.2. Minimum 180 students, respectively 90 students in the institution learning in minority community languages.</p> <p>3. A separate parallel may be established if, in addition to the general conditions referred to in paragraph 1 of this Article, these special conditions are also met:</p>	<p>9 razred;</p> <p>2.3.2. Minimum 120 učenika.</p> <p>2.4. Edukativno-obrazovna institucija nivo 1 i 2 prema ISCED ima:</p> <p>2.4.1. Najmanje po jedno odeljenje za 1-9 razred i najmanje jedno odeljenje za predškolski razred;</p> <p>2.4.2. Minimum 100 učenika, odnosno 50 učenika u institucijama u nastavi na jezik manjinskih zajednica i u planinskim i pograničnim oblastima;</p> <p>2.5. Edukativno-obrazovna institucija nivoa 3 prema ISCED ima:</p> <p>2.5.1. Najmanje po tri odeljenja za 10-12 razred;</p> <p>2.5.2. Minimum 180 učenika, odnosno 90 učenika u institucijama u nastavi na jezik manjinskih zajednica i u planinskim i pograničnim oblastima;</p> <p>3. Izdvojeno odeljenje može se osnovati ako su, pored opštih uslova iz stav 1 ovog člana, ispunjeni i sledeći posebni uslovi:</p>
--	---	--

<p>3.1. Largësia nga institucioni amë nuk është më e vogël se 4 km;</p> <p>3.2. I ka të paktën nga dy paralele të nivelit 1 dhe 2 sipas ISCED-it;</p> <p>3.3. I ka të paktën 20 nxënës, përkatësisht 10 në institucionin me mësim në gjuhët e komuniteteve pakicë dhe në zona malore e kufitare.</p> <p>4. Me përjashtim, paralelja e ndarë mund të themelohet edhe nëse nuk plotësohen kushtet e veçanta nga paragrafi 3 i këtij neni, në rast se transporti i fëmijëve nga zona e mbulimit të paraleles së ndarë deri tek shkolla më e afërt konsiderohet i rrezikshëm ose zgjat më shumë se 45 minuta në një drejtim.</p>	<p>3.1. Distance from the parent institution is not less than 4 km;</p> <p>3.2. It has at least two parallels of level 1 and 2 according to ISCED;</p> <p>3.3. It has at least 20 students, respectively 10 students in the institution learning in minority community languages.</p> <p>4. Exceptionally, a separate parallel may be established even if the special conditions referred to in paragraph 3 of this Article are not met, if the transport of children from the covered area of the separate parallel to the nearest school is considered dangerous or lasts more than 45 minutes in one direction.</p>	<p>3.1. Udaljenost od matične institucije nije manje od 4 km;</p> <p>3.2. Ima najmanje po dve odeljenja nivoa 1 i 2 prema ISCED;</p> <p>3.3. Ima najmanje 20 učenika, odnosno 10 u institucijama u nastavi na jezik manjinskih zajednica i u planinskim i pograničnim oblastima;</p> <p>4. Izuzetak, izdvojeno odeljenje se može osnovati i ako se ne ispunjavaju posebni uslovi iz stav 3. ovog člana, ako se prevoz dece iz zone pokrivanja područja izdvojenog odeljenja do najbliže škole smatra opasnim ili traje duže od 45 minuta u jednom pravcu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5</p> <p style="text-align: center;">Propozimi për themelimin e institucionit edukativ-arsimor ose paraleles së ndarë</p> <p>1. Propozimin për themelimin e institucionit edukativ-arsimor ose të paraleles së ndarë, e bën komuna.</p> <p>2. Propozimi nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të shoqërohet me këto dokumente:</p> <p>2.1. Argumentimin e domosdoshmërisë së hapjes së institucionit edukativ-arsimor publik ose paraleles së ndarë, përfshirë të</p>	<p style="text-align: center;">Article 5</p> <p style="text-align: center;">Proposal for the establishment of the educational institution or separate parallel</p> <p>1. The proposal for the establishment of the educational institution or separate parallel is done by municipality.</p> <p>2. The proposal from paragraph 1 of this Article shall be accompanied by these documents:</p> <p>2.1. Arguing the necessity of opening a public education institution or a separate classroom, including demographic data for</p>	<p style="text-align: center;">Član 5</p> <p style="text-align: center;">Predlaganje za osnivanje edukativno-obrazovne institucije ili izdvojeno odeljenje</p> <p>1. Predlog za osnivanje edukativno-obrazovne institucije ili izdvojenog odeljenja daje opština.</p> <p>2. Predlog iz stava 1 ovog člana mora biti praćen sledećom dokumentacijom:</p> <p>2.1. Neophodnost argumentovanje otvaranje javne edukativno-obrazovne institucije ili izdvojenog odeljenja,</p>

<p>dhëna demografike për komunitetin që jeton brenda zonës së mbulimit të institucionit;</p> <p>2.2. Argumentimin e plotësimit të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta nga neni 4 i këtij Udhëzimi;</p> <p>2.3. Dokumentin kadastral për pronësinë e parcelës së objektit arsimor;</p> <p>2.4. Planin e objektit arsimor;</p> <p>2.5. Lejen e ndërtimit ose vendimin për pranimin teknik të objektit;</p> <p>2.6. Kodin e propozuar të institucionit edukativ-arsimor;</p> <p>2.7. Dokumente të tjera që mbështesin propozimin.</p> <p>3. Propozimi duhet të dorëzohet në Ministri të paktën 3 muaj para fillimit të punës së institucionit edukativ-arsimor ose paraleles së ndarë.</p>	<p>the community living within the institution's coverage area;</p> <p>2.2. Arguing fulfilment of general and special conditions from Article 4 of this Article;</p> <p>2.3. Cadastral document for the ownership of the educational facility parcel;</p> <p>2.4. The educational facility plan;</p> <p>2.5. Construction permit or technical acceptance decision of the facility;</p> <p>2.6. Proposed code of educational institution;</p> <p>2.7. Other documents supporting the proposal.</p> <p>3. The proposal must be submitted to the Ministry at least 3 months prior to the commencement of the work of the educational institution or separate parallel.</p>	<p>uključujući demografske podatke o zajednici koja živi unutar područja pokrivanja institucije;</p> <p>2.2. Argumentovanje ispunjavanja opštih i posebnih uslova iz član 4 ovog Uputstva;</p> <p>2.3. Katastarski dokument za vlasništvo nad parcelom obrazovnog objekta;</p> <p>2.4. Plan obrazovnog objekta;</p> <p>2.5. Građevinska dozvola ili odluka o tehničkom prijemu objekta;</p> <p>2.6. Predloženi kod obrazovne institucije;</p> <p>2.7. Ostali dokumenti koji podržavaju predlog.</p> <p>3. Predlog se mora dostaviti Ministarstvu najmanje 3 meseca pre početka rada edukativno-obrazovne institucije ili izdvojenog odeljenja.</p>
<p>Neni 6 Verifikimi i kushteve</p>	<p>Article 6 Verification of conditions</p>	<p>Član 6 Provera uslova</p>
<p>1. Verifikimin e kushteve për zhvillimin e veprimtarisë edukative-arsimore në bazë të propozimit nga komuna, e bën komisioni i</p>	<p>1. The verification of the conditions for the development of the educational activity on the basis of a proposal from the municipality is</p>	<p>1. Provera uslova za razvoj edukativno-obrazovne aktivnosti na osnovu predloga opštine, vrši Komisija Ministarstva. Komisija</p>

<p>Ministrisë. Komisioni i ka 3 ose 5 anëtarë dhe emërohet nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë me mandat 4 vjeçar.</p> <p>2. Komisioni kryen verifikimin brenda afatit prej 60 ditësh nga dita e pranimit të propozimit.</p> <p>3. Komisioni analizon dokumentacionin, bën vizita në terren, konsultohet me specialistë brenda Ministrisë dhe, sipas nevojës, kërkon dokumente dhe informata shtesë nga komuna.</p> <p>4. Komisioni harton një raport gjithëpërfshirës me përfundim të qartë për pranueshmërinë e propozimit të komunës. Raporti i dorëzohet sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë.</p> <p>5. Vendimin për propozimin e komunës e merr sekretari i përgjithshëm i Ministrisë.</p> <p>6. Vendimi nga paragrafi 5 i këtij neni mund të jetë:</p> <p>6.1. Vendim për themelimin e institucionit edukativ-arsimor ose paraleles së ndarë në bazë të kompetencave të Ministrisë nga neni 3, paragrafi 1;</p> <p>6.2. Vendim për dhënien e pëlqimit për</p>	<p>done by the commission of the Ministry. The Commission has 3 or 5 members and is appointed by the General Secretary of the Ministry for a four-year term.</p> <p>2. The Commission shall carry out the verification within 60 days from the day of receipt of the proposal.</p> <p>3. The Commission analyses the documentation, makes field visits, consults specialists within the Ministry and, where appropriate, requests additional documents and information from the municipality.</p> <p>4. The Commission compiles a comprehensive report with a clear conclusion on the acceptability of the municipality's proposal. The report shall be submitted to the General Secretary of the Ministry.</p> <p>5. The decision on the proposal of the municipality is taken by the General Secretary of the Ministry.</p> <p>6. The decision from paragraph 5 of this Article may be:</p> <p>6.1. Decision on the establishment of an educational institution or a separate parallel based on the competences of the Ministry from Article 3, paragraph 1.</p> <p>6.2. Decision for granting consent to the</p>	<p>se sastoji od 3 ili 5 člana i imenuje generalni sekretar Ministarstva mandatom od 4 godine.</p> <p>2. Komisija vrši verifikaciju u roku od 60 dana od dana prijema predloga.</p> <p>3. Komisija analizira dokumentaciju, obavlja obilazak na terenu, konsultuje se sa stručnjacima unutar Ministarstva i, prema potrebi, traži dodatna dokumenta i informacije od opštine.</p> <p>4. Komisija sastavlja sveobuhvatni izveštaj sa jasnim zaključkom o prihvatljivosti predloga opštine. Izveštaj se dostavlja generalnom sekretaru Ministarstva.</p> <p>5. Odluku na predlog opštine donosi generalni sekretar Ministarstva.</p> <p>6. Odluka iz stava 5 ovog člana može biti:</p> <p>6.1. Odluka o osnivanju edukativno-obrazovne institucije ili izdvojenog odeljenja na osnovu kompetencije Ministarstva iz član 3 stav 1.</p> <p>6.2. Odluka kojom se daje saglasnost</p>
--	---	---

<p>komunën që të nxjerrë vendimin për themelimin e institucionit edukativ-arsimor ose paraleles së ndarë në bazë të kompetencave të komunës nga neni 3, paragrafi 3.</p> <p>6.3. Vendim për refuzimin e propozimit të komunës, i cili shoqërohet me arsyetim.</p> <p>7. Komuna mund të ushtrojë ankesë ndaj vendimit në Komisionin për ankesa në Ministri brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të tij.</p>	<p>municipality to issue a decision on the establishment of an educational institution or a separate parallel based on the competences of the municipality for Article 3, paragraph 3.</p> <p>6.3. Decision for rejecting the proposal of the municipality, which is accompanied by a justification.</p> <p>7. The municipality may appeal the decision to the Appeals Commission of the Ministry within 30 days of its receipt.</p>	<p>opštini da donese odluka o osnivanju edukativno-obrazovne institucije ili izdvojenog odeljenja na osnovu nadležnosti opštine iz člana 3 stav 3.</p> <p>6.3. Odluka o odbijanju predloga opštine, uz koju se prilaže obrazloženje.</p> <p>7. Opština može da podnese žalbu na odluku Komisije za žalbu u Ministarstvu u roku od 30 dana od dana prijema.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 Vendimi</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 Decision</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Odluka</p>
<p>1. Vendimi për themelimin e institucionit edukative-arsimor ose paraleles së ndarë përmban:</p> <p>1.1. Emrin e themeluesit;</p> <p>1.2. Komunën dhe vendin e institucionit edukativ-arsimor;</p> <p>1.3. Emrin e institucionit (nëse ka);</p> <p>1.4. Tipin e institucionit edukativ-arsimor;</p> <p>1.5. Kodin e institucionit edukativ-arsimor;</p> <p>1.6. Nivelin e veprimtarisë edukative-arsimore;</p>	<p>1. The decision to establish an educational institution or a separate parallel contains:</p> <p>1.1. Name of the founder;</p> <p>1.2. Municipality and location of educational institution;</p> <p>1.3. Name of institution (if any);</p> <p>1.4. Type of the educational institution;</p> <p>1.5. Code of the educational institution;</p> <p>1.6. Level of educational activity;</p>	<p>1. Odluka o osnivanju edukativno-obrazovne institucije ili izdvojeno odeljenje sadrži:</p> <p>1.1. Ime osnivača;</p> <p>1.2. Opština i mesto edukativno-obrazovne institucije;</p> <p>1.3. Ime institucije (ako ima);</p> <p>1.4. Tip edukativno-obrazovne institucije;</p> <p>1.5. Kod edukativno-obrazovne institucije;</p> <p>1.6. Nivo edukativno-obrazovne aktivnosti;</p>

<p>1.7. Gjuhët mësimore.</p> <p>2. Për institucionet edukative-arsimore dhe paralelet e ndara nga neni 3, paragrafi 1, vendimin e merr sekretari i përgjithshëm i Ministrisë siç është përshkruar në nenin 6, paragrafi 6, nënparagrafi 6.1.</p> <p>3. Për institucionet edukative-arsimore dhe paralelet e ndara nga neni 3, paragrafi 3, vendimin e merr kryetari i komunës, në bazë të vendimit për pëlqim të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Regjistri i institucioneve edukative-arsimore</p> <p>1. Ministria mban regjistrin qendror të institucioneve edukative-arsimore dhe paraleleve të ndara që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Regjistri përmban këto të dhëna për institucionin edukative-arsimor ose paralelen e ndarë:</p> <p>2.1. Kodin;</p> <p>2.2. Emrin;</p> <p>2.3. Komunën – vendin;</p> <p>2.4. Pronësinë;</p>	<p>1.7. Teaching languages.</p> <p>2. For educational institutions and separated parallels from Article 3, paragraph 1, the General Secretary of the Ministry takes the decision as described in Article 6, paragraph 6, sub-paragraph 6.1.</p> <p>3. For educational institutions and separated parallels from Article 3, paragraph 3, the decision is taken by the mayor, on the basis of the consent of the General Secretary of the Ministry.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Register of educational institutions</p> <p>1. The Ministry keeps the main register of educational institutions and separate parallels exercising activities in the territory of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The register contains these data on the educational institution or the separated parallel.</p> <p>2.1. Code;</p> <p>2.2. Name;</p> <p>2.3. Municipality – decision;</p> <p>2.4. Ownership;</p>	<p>1.7. Nastavni jezik.</p> <p>2. Za edukativno-obrazovne institucije i izdvojena odeljenja iz član 3, stav 1, odluku donosi generalni sekretar Ministarstva kao što je navedeno u član 6, podstav 6.1.</p> <p>3. Za edukativno-obrazovne institucije i izdvojena odeljenja prema član 3, stav 3 odluku donosi predsednik opštine, na osnovu odluke generalnog sekretara Ministarstva.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Registar edukativno-obrazovne institucije</p> <p>1. Ministarstvo vodi glavni registar edukativno-obrazovnih institucija i izdvojenih odeljenja koja deluju na teritoriji Republike Kosovo.</p> <p>2. Registar sadrži sledeće podatke o edukativno-obrazovnim institucijama ili izdvojena odeljenja:</p> <p>2.1 Kod;</p> <p>2.2. Ime;</p> <p>2.3. Opština - mesto;</p> <p>2.4. Vlasništvo;</p>
--	--	--



<p>2.5. Nivelin/-et sipas ISCED-it;</p> <p>2.6. Tipin për shkollat e mesme të larta;(gjimnaz, shkollë profesionale, shkollë e përzier, shkollë artistike, shkollë fetare etj.);</p> <p>2.7. Adresën e plotë;</p> <p>2.8. Telefonin;</p> <p>2.9. E-mail;</p> <p>2.10. Emrin e personit kontaktues;</p> <p>2.11. Datën e themelimit (nëse dihet);</p> <p>2.12. Numrin e aktit themelues (nëse ekziston).</p> <p>3. Institucionet arsimore dhe paralelet e ndara që pushojnë veprimtarinë fshihen nga regjistri.</p> <p>4. Regjistri është publik dhe përditësohet të paktën një herë në vit.</p>	<p>2.5. Level according to ISCED;</p> <p>2.6. Type for higher secondary schools (gymnasium, vocational school, mixed school, artistic school, religious school, etc.);</p> <p>2.7. Full address;</p> <p>2.8. Telephone;</p> <p>2.9. E-mail;</p> <p>2.10. Name of contact person;</p> <p>2.11. Date of establishment (if known);</p> <p>2.12. The number of the founding act (if any).</p> <p>3. Educational institutions and separate parallels that cease their activity are deleted from the register.</p> <p>4. The register is public and updated at least once a year.</p>	<p>2.5. Nivo prema ISCED;</p> <p>2.6. Tip više za više srednje škole; (gimanzije, profesionalne škole, škole miks, škole umetnosti, verske škole, itd);</p> <p>2.7. Puna adresa;</p> <p>2.8. Telefon;</p> <p>2.9. E-mail;</p> <p>2.10. Ime kontakt osobe;</p> <p>2.11. Datum osnivanja (ako se zna);</p> <p>2.12. Broj akta osnivanja (ako postoji).</p> <p>3. Obrazovne institucije i izdvojena odeljenja koje prestaju sa radom brišu se iz registar.</p> <p>4. Registar je javni i ažurira se najmanje jednom godišnje.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9</p> <p style="text-align: center;">Pushimi i veprimtarisë së institucionit edukativ-arsimor ose paraleles së ndarë</p> <p>1. Pushimi i veprimtarisë së institucionit edukativ-arsimor ose paraleles së ndarë mund të iniciohet nga Ministria ose komuna përkatëse në</p>	<p style="text-align: center;">Article 9</p> <p style="text-align: center;">Termination of the activity of the educational institution or the separated parallel</p> <p>1. Termination of the activity of the educational institution or the separated parallel can be initiated by the Ministry or the respective</p>	<p style="text-align: center;">Član 9</p> <p style="text-align: center;">Prestanak aktivnosti edukativno-obrazovne institucije ili izdvojenog odeljenja</p> <p>1. Prestanak aktivnosti edukativno-obrazovne institucije ili izdvojenog odeljenja može inicirati ministarstvo ili dotična opština u</p>

<p>këto raste:</p> <p>1.1. Nëse institucioni ose paralelja e ndarë nuk i plotëson kushtet në kuptim të nenit 4 të këtij Udhëzimi;</p> <p>1.2. Nëse nuk ekziston arsyeshmëria për vazhdimin e veprimtarisë;</p> <p>1.3. Nëse me vazhdimin e veprimtarisë rrezikohet shëndeti dhe siguria e fëmijëve/nxënësve;</p> <p>1.4. Me rekomandimin e organit përgjegjës të inspektoratit pas një inspektimi gjithëpërfshirës të institucionit ose paraleles së ndarë.</p> <p>2. Iniciativa për pushimin e veprimtarisë së institucionit edukativ-arsimor ose paraleles së ndarë, përmban argumentim të detajuar për arsyet e pushimit të veprimtarisë, duke ju referuar kushteve ligjore, respektivisht rrethanave objektive që justifikojnë një hap të tillë. Në veçanti, duhet të përmbajë një plan për:</p> <p>2.1. Mundësitë konkrete të transferimit të fëmijëve/nxënësve të institucionit/paraleles që do të pushojë veprimtarinë në një institucion tjetër edukativ-arsimor publik;</p> <p>2.2. Procedurat e transferimit të fëmijëve/nxënësve të institucionit/paraleles që do të pushojë së vepruari në një institucion</p>	<p>municipality in these cases:</p> <p>1.1. If the institution or the separate parallel does not meet the conditions regarding Article 4 of this Instruction;</p> <p>1.2. If there is no justification for continuing the activity;</p> <p>1.3. If with continuation of the activity is endangered the health and safety of children / students;</p> <p>1.4. Upon the recommendation of the responsible body of the inspectorate following a comprehensive inspection of the institution or the separate parallel.</p> <p>2. The initiative for termination of the activity of the educational institution or a separate parallel contains detailed arguments for the reasons for termination of the activity, referring to the legal conditions, namely the objective circumstances justifying such a step. In particular, it should contain a plan for:</p> <p>2.1. Concrete opportunities for transferring children / students of the institution / parallel that will cease the activity in another public educational institution;</p> <p>2.2. Procedures for transferring children / students of the institution / parallel that will cease operating in another institution / other</p>	<p>sledećim slućajevima:</p> <p>1.1. Ako institucija ili izdvojeno odeljenje ne ispunjava uslove u smislu ćlana 4 ovog uputstva;</p> <p>1.2. Ako ne postoji opravdanost za nastavak aktivnosti;</p> <p>1.3. Ako nastavak aktivnosti ugroćava zdravlje i sigurnost dece / ućenika;</p> <p>1.4. Po preporuci odgovornog tela inspektorata nakon sveobuhvatne inspekcije institucije ili izdvojenog odeljenja.</p> <p>2. Inicijativa za prestanak aktivnosti obrazovne institucije ili izdvojenog odeljenja sadrži detaljne argumente o razlozima za prekid aktivnosti, pozivajući se na zakonske uslove, odnosno objektivne okolnosti kojima se opravdava takav korak. Posebno treba da sadrži plan za:</p> <p>2.1. Konkretno mogućnosti za prebacivanje dece / ućenika institucije / odeljenja koja će prestati sa radom u drugoj javnoj edukativno-obrazovnoj instituciji;</p> <p>2.2. Procedure prebacivanja dece / ućenika institucije / odeljenja koja će prestati sa radom u drugoj instituciji / drugim javnim</p>
--	--	---

<p>tjetër/institucione të tjera edukative-arsimore publike;</p> <p>2.3. Përcaktimin e destinacionit të inventarit të orendive, mjeteve mësimore etj. të institucionit;</p> <p>2.4. Përcaktimin e mundësive për punësim të personelit të institucionit edukativ-arsimor/paraleles që pushon së vepruari.</p> <p>3. Gjatë përgatitjes së iniciativës nga paragrafi 2 i këtij neni, Ministria merr të gjithë hapat e nevojshëm për sigurimin e të dhënave dhe përgatitjen e planeve të veprimit si: vizitat në terren, konsultime me komunën dhe shkollën, konsultime me specialistë kompetentë brenda Ministrisë, etj. Anëtarët e Komisionit të Ministrisë, të themeluar në përputhje me nenin 6, paragrafi 1 i këtij Udhëzimi, nuk mund të përfshihen në procesin e përgatitjes së iniciativës.</p> <p>4. Iniciativa shqyrtohet nga Komisioni i Ministrisë i themeluar në përputhje me nenin 6, paragrafi 1 i këtij Udhëzimi. Komisioni vepron sipas procedurës së përshkruar në nenin 6, paragrafi 3.</p> <p>5. Komisioni harton një raport gjithëpërfshirës me përfundim të qartë për pranueshmërinë e iniciativës për pushimin e veprimtarisë së institucionit ose paraleles së ndarë.</p>	<p>public educational institutions;</p> <p>2.3. Determining the destination of the furniture's inventory, teaching means etc, of the institution;</p> <p>2.4. Determination of employment opportunities for the staff of the educational institution / parallel that ceases to operate.</p> <p>3. During preparation of the initiative from paragraph 2 of this Article, the Ministry takes all necessary steps to obtain data and prepare action plans such as: site visits, consultation with the municipality and the school, consultations with competent specialists within the Ministry, etc. Members of the Ministry Commission established in accordance with Article 6, paragraph 1 of this Instruction, cannot be involved in the process of preparing the initiative.</p> <p>4. The initiative is reviewed by the Commission of the Ministry established in accordance with Article 6, paragraph 1 of this Instruction. The Commission acts in accordance with the procedure set out in Article 6, paragraph 3.</p> <p>5. The Commission compiles a comprehensive report with a clear conclusion on the acceptability of the initiative to cease the activity of the institution or separate parallel.</p>	<p>edukativno obrazovnim institucijama;</p> <p>2.3. Određivanje lokacije za inventara nameštaja, nastavna sredstava itd. institucije;</p> <p>2.4. Određivanje mogućnosti zapošljavanje osoblja edukativno-obrazovne institucije/ odeljenja koje prestaje sa radom.</p> <p>3. Prilikom pripreme inicijative iz stava 2. ovog člana, Ministarstvo će preduzeti sve neophodne korake za obezbeđivanje podataka i pripremu akcionih planova kao što su: obilazak lokacije, konsultacije sa opštinom i školom, konsultacije sa nadležnim stručnjacima unutar Ministarstva, itd. Članovi komisije Ministarstva, osnovano u skladu sa članom 6. stav 1. ovog uputstva ne mogu biti uključeni i u procesu pripremanje inicijative.</p> <p>4. Inicijativu preispituje Komisija Ministarstva osnovana u skladu sa članom 6. stav 1. ovog uputstva. Komisija postupa u skladu s procedurom utvrđenom u članu 6. stav 3.</p> <p>5. Komisija sastavlja sveobuhvatni izveštaj sa jasnim zaključkom o prihvatljivosti inicijative za prekid aktivnosti institucije ili izdvojenog odeljenja.</p>
--	---	---

<p>6. Vendimin për iniciativën e merr sekretari i përgjithshëm i Ministrisë.</p> <p>7. Vendimi mund të jetë:</p> <p>7.1. Vendim për pushimin e veprimtarisë së institucionit edukativ-arsimor ose paraleles së ndarë në bazë të kompetencave të Ministrisë nga neni 3, paragrafi 1;</p> <p>7.2. Rekomandim për komunën që të nxjerrë vendimin për pushimin e veprimtarisë së institucionit edukativ-arsimor ose paraleles së ndarë në bazë të kompetencave të komunës nga paragrafi 3 i nenit 3 të këtij UA;</p> <p>7.3. Vendim për refuzimin e iniciativës për pushimin e veprimtarisë së institucionit edukativ-arsimor ose paraleles së ndarë me arsyetim përkatës.</p> <p>8. Ndaj vendimit nga paragrafi 7, nënparagrafët 7.1 dhe 7.3 të këtij neni, komuna mund të ushtrojë ankesë në Komisionin për ankesa në Ministri brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.</p>	<p>6. The decision on the initiative is taken by the General Secretary of the Ministry.</p> <p>7. The decision can be:</p> <p>7.1. The decision on termination of the activity of an educational institution or a separate parallel based on the competences of the Ministry from Article 3, paragraph 1.</p> <p>7.2. Recommendation to the municipality to issue a decision on termination of the activity of the educational institution or a separate division based on the competences of the municipality from paragraph 3 of article 3 of this AI.</p> <p>7.3. The decision to reject the initiative for termination of the activity of the educational institution or the separated parallel with appropriate justification.</p> <p>8. Toward decision from paragraph 7, subparagraph 7.1 and 7.3 of this Article, municipality can file a complaint at the Appeal Commission in the Ministry within 30 days from the day of receipt of decision.</p>	<p>6. Odluku o inicijativi donosi generalni sekretar Ministarstva.</p> <p>7. Odluka može biti:</p> <p>7.1. Odluka o prestanku aktivnosti edukativno-obrazovne institucije ili izdvojenog odeljenja na osnovu nadležnosti Ministarstva iz člana 3 stav 1.</p> <p>7.2. Preporuka za opštinu koja donesi odluku o prestanku aktivnosti edukativno-obrazovne institucije ili izdvojenog odeljenja na osnovu nadležnosti opštine iz stav 3 član 3 ovog AU.</p> <p>7.3. Odluka o odbijanju inicijative za prestanak aktivnosti edukativno-obrazovne institucije ili izdvojenog odeljenja sa odgovarajućim obrazloženjem.</p> <p>8. Na odluku iz stava 7, podstav 7.1 i 7.3 ovog člana, opština može podneti žalbu Komisiji za žalbe u Ministarstvu u roku od 30 dana od prijema rešenja iz stava.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Dispozitat kalimtare</p> <p>1. Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ, të gjitha institucionet edukative-</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Transitional provisions</p> <p>1. Upon entry into force of this Administrative instruction, all public educational institutions</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Prelazne odredbe</p> <p>1. Stupanjem na snagu ovog Administrativnog uputstva, sve javne</p>

<p>arsimore publike dhe paralelet e ndara të tyre që ushtrojnë veprimtari, si dhe institucionet private të licencuara, përfshihen në regjistrin e institucioneve arsimore.</p> <p>2. Regjistri i institucioneve arsimore publikohet në uebfaqen e Ministrisë në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ.</p> <p>3. Për të gjitha institucionet arsimore dhe paralelet e ndara që janë në proces themelimi, zbatohen aktet nënligjore që kanë qenë në fuqi në kohën e fillimit të procedurës, por me kusht që procesi të përfundojë më së voni 3 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ. Në të kundërtën, procesi duhet të rifillojë sipas kërkesave të këtij Udhëzimi administrativ.</p>	<p>and their separate parallels exercising the activity, and the licenced private institutions are included in the register of the educational institutions.</p> <p>2. The register of educational institutions is published in the webpage of the Ministry within 3 months from the day of entry into force of this Administrative instruction.</p> <p>3. To all educational institutions and separate parallels that are in the process of establishment, sub-legal acts that have been in force at the time of beginning the procedure are applied, but on conditions that the process to end at latest 3 months after the entry into force of this Administrative instruction. Otherwise, the process should recommence according to requests of this Administrative instruction.</p>	<p>edukativno-obrazovne institucije i njihova izdvojena odeljenja koje sprovode aktivnosti, kao i licencirane privatne institucije su obuhvaćene u registar obrazovnih institucija.</p> <p>2. Registar javnih obrazovnih institucija se objavljuje na web stranici Ministarstva u roku od tri meseca od dana stupanja na snagu ovog Administrativnog uputstva.</p> <p>3. Za sve obrazovne institucije i izdvojena odeljenja koja su u procesu osnivanja primenjuju se podzakonski akti koji su bili na snazi u vreme početka procedure, ali pod uslovom da proces završi najkasnije u roku od 3 meseca od stupanja na snagu ovog Administrativnog uputstva. U suprotnom, proces se mora ponoviti kako se zahteva ovim Administrativnim uputstvom.</p>
<p>Neni 11 Dispozitat shfuqizuese</p>	<p>Article 11 Repealing provisions</p>	<p>Član 11 Vansnažne odredbe</p>
<p>Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ, shfuqizohen Udhëzimi administrativ nr. 9/2008 i dt. 26.05.2008, Udhëzimi administrativ nr. 29/2012 dt. 31.10.2012 dhe Udhëzimi administrativ nr. 8/2015 dt. 10.08.2015.</p>	<p>Upon entry into force of this Administrative instruction are repealed Administrative instruction no. 09/2008 dated 26.05.2008, Administrative instruction no. 29/2012 dated 31.10.2012 and Administrative instruction no. 8/2015 dated 10.08.2015.</p>	<p>Stupanjem na snagu ovog Administrativnog uputstva stavlja se van snage Administrativno uputstvo br. 9/2008 dat. 26.05.2008, Administrativno uputstvo br. 29/2012 dat. 31.10.2012 i Administrativno uputstvo br. 8/2015 dat. 10.08.2015.</p>

<p align="center">Neni 12 Hyrja në fuqi</p>	<p align="center">Article 12 Entry into force</p>	<p align="center">Član 12 Stupanje na snagu</p>
<p>Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri.</p> <p align="center">  Ramë Likaj  Ministër </p> <p>Datë: <u>14</u> / <u>01</u> / <u>2025</u></p>	<p>This administrative instruction enters into force seven (7) days after being signed by the Minister.</p> <p align="center"> Ramë Likaj, <hr/> Minister </p> <p>Date: <u> </u> / <u> </u> / <u> </u></p>	<p>Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana nakon potpisivanja od strane Ministra.</p> <p align="center"> Ramë Likaj, <hr/> Ministar </p> <p>Dat: <u> </u> // <u> </u> // <u> </u></p>



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:		Ramë Likaj, Minister /MASH <i>Ramë Likaj</i>			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:		Agim Bërdyna, u.d. sekretar i përgjithshëm /MASH <i>Agim Bërdyna</i>			
NGA/OD/FROM:		Fadile Dyla drejtore, DIEKPÇL <i>Fadile Dyla</i> Elhame Shabani, zyrtare e lartë ligjore <i>Elhame Shabani</i>			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Dërgimi i draftudhëzimit administrativ për nënshkrim: U.A. "Për Kriteret dhe Procedurat e Themelimit dhe Pushimit të Veprimtarisë së Institucioneve të Arsimit Parauniversitar"			
Nr. i zyrës:	211	Lokacioni:	MASH	Data:	28.08.2020
Br. Kancelarije:	20 105	Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËË DISCUSS					
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

I nderuar,

Bashkangjitur shkresës gjeni draftudhëzimin administrativ "Për Kriteret dhe Procedurat e Themelimit dhe Pushimit të Veprimtarisë së Institucioneve të Arsimit Parauniversitar".

Gjithashtu ju njoftoj se në bazë të njoftimit nga iniciuesi i hartimit të tij ky draftudhëzim e ka kaluar konsultimin paraprak dhe diskutimin publik.

Me respekt!